REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 02-507
Data/Datum:/Date: 15/04/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr.30/2026
Datë:15/04/2026

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 mars 2019, bazuar në Ligjin e Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-68, pjesa IV, neni 81, si dhe neni 70, Rregullores për Prokurim Publik me nr. 001/2022, mbi aktivitetin e menaxhimit te Kontratës, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Edona Berisha, Zyrtare e Lartë për Mbështetjen e Viktimave të Krimit, caktohet përgjegjëse për menaxhimin e kontratës, dhe për mbikëqyrjen e realizuar te obligimeve dhe detyrave kontraktuese te specifikuar si në kontratë me titull: **Furnizimi me lule për Ministrinë e Drejtësisë dhe njësitë e saj, më nr. te kontratës: 215-26-865-1-3-6/C156**
2. Zyrtarja përgjegjëse për menaxhimin e kontratës nga pika 1 e këtij vendimi ka për detyre që:
   2.1. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e përformancës apo dërgesës në përputhje me termat e referencës dhe kushtet e kontratës;
   2.2. Të siguroj që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
   2.3. Të siguroj që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
   2.4. Të siguroj se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
   2.5. Të siguroj që të gjitha obligimet janë kompletuara para mbylljes së dosjes së kontratës;
   2.6. Të siguroj që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;

2.7. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

2.8. Të siguroj detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Divizionit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;

2.9. Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit;

2.10. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Divizionit të Prokurimit dhe

2.11. Të dorëzoj raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga ZKA dhe Divizionin i Prokurimit.

3. Obligohet i lartcekuri që detyrat dhe përgjegjësitë e tij ti kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi ju dërgohet:

- *Znj. Edona Berisha;*
- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;*
- *Divizionit të Prokurimit; dhe*
- *Arkivit të MD-së.*